



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 610/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Nehat Idrizi kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkatësisht për ankesat e subjekteve politike Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Fryma e Re (FER), në lidhje me parregullsi gjate procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 17.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

HIDHEN poshtë si të pasafatshme ankesat me numër lende A610, A612, A617, A618, A619, A621, A624, A627, A642, A643 dhe A644, të subjekteve politike Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Fryma e Re (FER)

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar ankesat me numër lende, date dhe ore si me poshtë:

Ne A610 – me dt, 13.12.2010, në orën 19:55 minuta, subjekti politik PDK ka parashtruar ankese që paneli të shqyrtojë çështjen e mbarëvajtjes së zgjedhjeve dt.12.12.2010, në komunën e Skenderaj;

Ne A612- me dt, 13.12.2010, në orën 20:50 minuta, subjekti politik PDK pretendon se votat e kandidatit të PDK-së Bahri Hyseni, i janë bartur një kandidatit tjetër;

Ne A617- me dt, 14.12.2010, në orën 11:15 minuta, subjekti politik PDK pretendon se kandidati i LVV-së ka ushtruar presion mbi kandidatin e PDK-së;

Ne A618- me dt, 14.12.2010, në orën 11:15 minuta, subjekti politik PDK pretendon se LDK ka kryer fushatë zgjedhore përgjatë periudhës së heshtjes zgjedhore në QV 2058/A, Prizren;

Ne A619- me dt, 14.12.2010, në orën 11:15 minuta, subjekti politik PDK parashtron se QV 2030A, Lugshti i Hasit, vëzhguesi i OJQ-së KDI me automjetin e organizatës ka bartur aktivistet e AAK-së me qellim që këta të fundit të votonin në grup;

Ne A621- me dt, 14.12.2010, ne orën 14:35 minuta, subjekti politik PDK pretendon se ne QV 1909/e VV 05 komisioneri i LVV-se ka kërkuar vazhdimisht te fotografoj dhe incizoj fletëvotimet;

Ne A624- me dt, 14.12.2010, ne orën 15:30 minuta, subjekti politik FER parashtron se ne Glllogovac, ne VV 0311/01R formulari i i rezultateve te komisionereve nuk eshte nënshkruar;

Ne A627- me dt, 14.12.2010, ne orën 16:20 minuta, subjekti politik PDK parashtron se ne Lipjan, QV 1328 me dt, 12.12.2010 kane qene te vendosur posterat e LDK-se;

Ne A642- me dt, 15.12.2010, ne orën 15:40 minuta, subjekti politik PDK pretendon se ne Kacanik, ne VV 01R dhe 02R pas përfundimit te numërimit te votave disa njerëz kane detyruar komisioneret qe te mbyllin derën dhe te përshkruajnë votat e kandidatëve te cilët nuk ishin votuar prej qytetareve;

Ne A643- me dt, 15.12.2010, ne orën 15:40 minuta, subjekti politik PDK ka parashtruar se ne VV 01R dhe 06R, Kacanik, janë falsifikuar raportet duke eliminuar votat e kandidatit te PDK-se Bahri Hyseni; dhe

Ne A644- me dt, 15.12.2010, ne orën 15:40 minuta, subjekti politik PDK ka parashtruar se ne Biqeve-Kacanik QV 0705D gjate përpilimit te raportit përfundimtar kandidatit Bahri Hyseni nuk i kane kaluar te gjitha votat e merituar.

Neni 119 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

119.1 "Personi i cili ka interes ligjor ne një ceshtje brenda juridiksionit te PZAP ose te drejtat e te cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor te rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund te paraqes enje ankesa pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i mbylljes qe qendrës se votimit, dhe PZAP-i do te vendos për ankesën brenda shtatëdhjetedy (72) orëve nga koha kur është pranuar ankesa".

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 4.2 dhe 6.3 parasheh si vijon:

4.2 "PZAP mund ti hedhe poshtë si te palejuara, te parregullta dhe te pasafatshme, ankesat te cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara ne nenin 3 te këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat te cilat janë te pabazuara, apo te cilat nuk janë ne përputhje me dispozitat e duhura ligjore. Ne rast se ankesa nuk i plotëson këto kriteret, PZAP mund ti japë palës ankuese një periudhe te arsyeshme kohore, siç është parapare ne njoftim, për ti plotësuar ato kriteret".

6.3 "Me qellim te lehtësimit te shqyrtimit te ankesave, Kryesuesi i panelit mund te vendose ta bej bashkimin e ankesave qe përmbajnë ne vete ceshtje te ngjashme, paneli vendim-marres i trajton ato ankesa sikurse te ishin një ankesë".

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

- ankesa janë të pasafatshme

Pretendimet nga parashtruesit e ankesave janë të pasafatshme, pasi këto ankesa në përputhje me nenin 119.1 të LPZ-se dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP, janë parashtruar pasi afati i parapare ligjor për dorëzimin e tyre pranë këtij institucioni ka kaluar. Prandaj për këtë arsye si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, PZAP vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 610/2010 më datën 17.12.2010.

Kryesuesi i Panelit

Nehat Idrizi

